




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-1933/21 datë: 20.01.2021



Npi – 01/18 datë: 28.01.2021

Bazuar në: Nenin 12.2. pika (d) dhe nenin 17 pika (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Ligjin Nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës; Ligjin Nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Ligjin Nr.02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma; Ligjin Nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës; Ligjin Nr.03/L-153 për pyjet e Kosovës; Planin Zhvillimor të Komunës së Shtimes 2010-2020; Planin Rregullues Urban të Komunës së Shtimes; Planin për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Shtimes 2016-2021; Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2019-2021; Planin për Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Shtimes; Planin për Investime të Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Shtimes 2016-2021; Planin i Mobilitetit Urban për Komunën e Shtimes 2016-2020; Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Shtimes 2019-2022; Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Rural në Komunën e Shtimes 2015-2019; Kuvendi i Komunës, mori parasysh edhe Rekomandimet e Drejtorisë për Shërbime Publike, Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe diskutimin publik me qytetarë, në mbledhjen e mbajtur më 28.01.2021, Aprovoi:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS 2021-2025

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2021, e mbajtur më: 28.01.2021, me shumicën e votave aprovoi Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2021-2025, në komunën e Shtimes.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj